




# DIALOGU DHE

# WAPRESENTUEN


# WESYSTEME

# QYTYAREVE

Janar 2017



# 2017











QUALITÄT

PREMIEN

SYSTEME

MYNTERREWE



COPYRIGHT © 2017. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10 000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

**Disclaimer:** Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit “Forcimi i mbikëqyrjes parlamentare të ekzekutivit dhe rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në dialogun Kosovë-Serbi”, i financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës.



# PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE</b> .....	<b>6</b>
<b>2. METODOLOGJIA</b> .....	<b>7</b>
<b>3. MARRËVESHJA PËR TELEKOMUNIKACIONIN</b> .....	<b>8</b>
3.1 CILA ËSHTË RRJEDHA E KËSAJ MARRËVESHJEJE? .....	8
3.2 DEBATI RRETH MARRËVESHJES .....	8
3.3 PERCEPTIMI QYTETAR.....	9
3.3.1 SA JENI TË INFORMUAR ME PËRMBAJTJEN E MARRËVESHJES PËR KODIN TELEFONIK TË KOSOVËS (+383)? .....	9
3.3.2 KUSH MENDONI SE PËRFITON NGA MARRËVESHJA E KODIT TË RI TELEFONIK +383?.....	10
<b>4. ASOSACIONI/BASHKËSIA E KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE</b> .....	<b>11</b>
4.1 CILA ËSHTË RRJEDHA E KËSAJ MARRËVESHJEJE? .....	11
4.2 DEBATI RRETH MARRËVESHJES .....	11
4.3 PERCEPTIMI QYTETAR.....	12
4.3.1. ÇFARË KOMPETENCASH MENDONI SE DO TË KETË ASOCIACIONI I KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE?.....	12
<b>5. KE ARDHMJA E DIALOGUT KOSOVË-SERBI NGA KËNDVËSHTRIMI I QYTETARËVE</b> .....	<b>14</b>
5.1 NGA KUSH MENDONI SE DUHET TË UDHËHIQET NË TË ARDHMEN DIALOGU KOSOVË-SERBI? .....	14
5.2. CILAT TEMA TJERA MENDONI SE DUHET TË DISKUTOHEN NË KUADËR TË DIALOGUT KOSOVË – SERBI? .....	16
<b>6. PËRFUNDIM</b> .....	<b>18</b>



# HYRJE

Hulumtimi i opinionit publik “Dialogu dhe marrëveshjet në sytë e qytetarëve” është i dyti që KDI organizon për të nxjerr në pah këndvështrimin e qytetarëve rreth procesit të dialogut Kosovë-Serbi.

Kësaj rradhe, në fokus të sondazhit janë vënë dy marrëveshje shumë të diskutuar në qarqet politike por edhe në opinionin publik në Republikën e Kosovës: marrëveshja për telekomunikacionin, e njohur ndryshe si marrëveshja për kodin telefonik, dhe marrëveshja për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Më konkretisht, përmes pyetjeve të shtruara në këtë hulumtim, KDI synon tu përgjigjet dilemave të shumta të ngritura në opinionin publik lidhur me faktin se sa dijnë qytetarët për marrëveshjen për telekomunikacionin, cili shtet mendojnë që përfiton më tepër nga kjo marrëveshje dhe çfarë kompetenca do të ketë Asociacioni/Bashkësia e Komunave me shumicë serbe kur ai të themelohet.

Në të njëjtën kohë, zyrtarët e lartë të shtetit të Kosovës gjatë vitit 2016 kanë deklaruar disa herë se dialogu do të ketë një fazë të tretë dhe përmbyllëse të tij, me tema të reja të diskutimit. KDI ka konsultuar qytetarët mbi atë se si e shohin të ardhmen e dialogut dhe kush sipas tyre duhet të përfaqësoj Republikën e Kosovës në këto diskutime.

Rezultatet e sondazhin reflektojnë nevojën për të rritur transparencën, për të njoftuar qytetarët rreth efektëve që marrëveshjet specifike sjellin në jetën e qytetarëve si dhe nxjerr në pah qëndrimin e qytetarëve rreth së ardhmes së dialogut si dhe temat të cilat ata vlerësojnë se duhet të diskutohen në kuadër të këtij procesi.

Këto sondazhe organizohen në kuadër të misionit të KDI-së për të promovuar llogaridhënien dhe demokracinë e përgjegjshme dhe projektit të financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës për forcimin e mbikëqyrjes parlamentare të ekzekutivit dhe rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në dialogun Kosovë-Serbi.





## 2. METODOLOGJIA


Sondazhi është zhvilluar në nivel vendi duke përdorur metodën sistematike të rastësisë, me mostër prej 1070 të anketuarëve e dizajnuar për sigurimin e mostrës përfaqësuese, e shtresuar sipas etniciteteve: shqiptar, serb dhe

minoritete jo-serbe, shtrirja sipas vendbanimeve (ubane/rurale). Sondazhi është realizuar në periudhën kohore 10-19 Dhjetor 2016. Margjina e gabimit është rreth  $\pm 3\%$ .









## 3.3 PËRCEPTIMI QYTETAR

### 3.3.1 Sa jeni të informuar me përbajtjen e marrëveshjes për Kodin telefonik të Kosovës (+383)?

Pas debateteve të shumta dhe opinioneve të ndryshme të paraqitura qoftë nga spektri politik si dhe ai i shoqërisë civile, KDI i ka pyetur qytetarët rreth perceptimit të tyre rreth kësaj marrëveshjeje për të nxjerr në pah se sa janë ata të informuar.


Nga rezultatet e sondazhit del se gjysma e të anketuarve kanë njohuri për këtë marrëveshje, ku rreth 4% e qytetarëve kanë


deklaruar se janë plotësisht të informuar, ndërsa rreth 45% e tyre kanë deklaruar se janë të informuar.

Në anën tjetër, në total 48% e qytetarëve në përgjithësi janë të painformuar rreth kësaj marrëveshjeje, ku 23% e qytetarëve kanë deklaruar se janë plotësisht të painformuar rreth saj dhe rreth 25% e tyre të painformuar. Vetëm 2.7% e qytetarëve kanë preferuar të mos japin përgjigje.

Sa i përket ndarjes në grupe etnike, sipas këtij sondazhi rezultojnë se të anketuarit nga komuniteti shqiptar janë më të informuar rreth përbajtjes së kësaj marrëveshjeje, ku 51% e tyre kanë deklaruar se janë të informuar me përbajtjen e marrëveshjes për kodin telefonik. Përkundrajt të anketuarëve nga komuniteti serb ku 21% të tyre janë deklaruar se janë të painformuar si dhe 36% nga komunitetet tjera joshumicë në Republikën e Kosovës. Më të painformuarit rezultojnë të jenë qytetarët e komunitetit serb, rreth 75% e të anketuarëve, të ndjekur nga qytetarët e komuniteteve të tjera, rreth 60% e tyre, dhe në fund qytetarët e komunitetit shqiptar me rreth 46% e tyre.

### Sa jeni të informuar për përbajtjen e marrëveshjes për kodin telefonik





### 3.3.2 Kush mendoni se përfiton nga marrëveshja e kodit të ri telefonik +383?

Një ndër çështjet më të diskutuara pas arritjes së marrëveshjes për kodin telefonik është se cili shtet përfiton më shumë nga kjo marrëveshje. Qëndrimet rreth kësaj dileme ishin të ndryshme, varësisht nga pikëpamjet politike që përfaqësonin individ të caktuar. Por çfarë mendojnë qytetarët rreth kësaj çështjeje?


Sipas hulumtimit të realizuar, shumica e të anketuarëve përkatësisht 32% nuk e dinë se cili shtet përfiton nga kjo marrëveshje. 21% e të anketuarëve vlerësojnë se të dy shtetet përfitojnë nga kjo marrëveshje, ndërsa 27% e të tyre deklarohen se përfituese e saj është Republika e Kosovës karshi 16% të të anketuarëve të cilët mendojnë se përfituese e kësaj marrëveshjeje është shteti i Serbisë. Vetëm 4.8% e të anketuarëve kanë deklaruar se asnjëri shtet nuk do të përfitojë nga kjo marrëveshje.

Nëse analizojmë trendet e qëndrimeve të të anketuarëve sipas përkatësisë etike, shumica nga komuniteti shqiptar përkatësisht 32% kanë deklaruar nuk e dijnë se cili shtet përfiton nga kjo marrëveshje, rreth 13% e të anketuarëve nga komuniteti serb dhe 52% e të anketuarëve nga komunitetet e tjera.

Megjithatë, numër më i madh i shqiptarëve besojnë se Kosova përfiton më shumë nga kjo marrëveshje rreth 27% e tyre. Më tej, ndërsa 21% e të anketuarëve nga komuniteti serb dhe 27% e të anketuarëve nga komunitetet e tjera.

Në anën tjetër, rreth 21% e komunitetit shqiptar deklarojnë se të dy shtetet përfitojnë, ndërsa 24% e komunitetet serb ndajnë të njëjtim mendim. Kurse, rreth 17% e të anketuarëve nga komuniteti shqiptar kanë deklaruar se është shteti i Serbisë ai që përfiton nga marrëveshja, vetëm 9% e komunitetit serb kanë deklaruar një gjë të tillë. Rreth 17% e komunitetit serb deklarohen se asnjë shtet nuk përfiton, përkundrazi vetëm 5% të komunitetit shqiptar.

### Cili shtet përfiton nga marrëveshja për telekomunikacionin?





# 4. ASOCIACIONI/BASHKËSIA E KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE

## 4.1 Cila është rrjedha e kësaj marrëveshje?

Marrëveshja mbi Parimet e Përgjithshme të Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë u arrit me datën 25 gusht të vitit 2015, mes Kryeministrit të Kosovës Isa Mustafa dhe Kryeministrit të Serbisë Aleksandar Vuçiç. Kjo marrëveshje derivon nga marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve, e arritur më 19 prill të vitit 2013.

Në 22 pikat e saj marrëveshja mbi Parimet e Përgjithshme përcakton detajet e formimit të Asociacionit/Bashkësisë së komunave serbe në Kosovë duke përfshirë, kornizën ligjore, objektivat, strukturën organizative, marrëdhëniet me autoritetet qendrore, kapacitetin ligjor, buxhetin dhe përkrahjen (përfshirë përkrahja nga shteti i Serbisë), dispozitat e përgjithshme dhe përfundimtare.

Gjithashtu në të përcaktohen veprimet e shtetit të Kosovës për formimin e këtij mekanizmi përkatësisht se Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë do të themelohet siç parashihet me Marrëveshjen e Parë, Ligjin mbi Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë (i miratuar më 27 qershor 2013 në Kuvend) dhe ligjet e Kosovës. Si dhe në bazë të Marrëveshjes së Parë, e cila njih karakterin e tij të veçantë, Qeveria e Kosovës do të miratojë një dekret të aplikueshëm drejtpërdrejtë, i cili do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.<sup>5</sup>

Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal më 14 Qershor 2013, ka nxjerr vendimin nr. 02-779 për formimin e grupit menaxhues për përgatitjen e themelimit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe.<sup>6</sup>

<sup>5</sup> [http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/TekstilMarrveshjes\\_25gusht2015\\_EVDK4S6aE9.pdf](http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/TekstilMarrveshjes_25gusht2015_EVDK4S6aE9.pdf)

<sup>6</sup> Koha: Formohet ekipi për themelimin e Bashkësisë së Komunave Serbe në Kosovë - <http://koha.net/?id=27&l=131804> (qasur me 12.10.2016)

Si rezultat i krizës politike të krijuar atë kohë në Kosovë, ish-Presidentja e Kosovës znj. Atifete Jahjaga i drejtoi Gjykatës Kushtetuese kërkesën për interpretimin e përputhshmërisë së parimeve të Asociacionit me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Në vendimin prej 39 faqesh, Gjykata konstatoi se parimet e kësaj marrëveshjeje nuk janë tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, deklaroi se Asociacioni do të themelohet, siç është paraparë me Marrëveshjen e Prillit të vitit 2013, e ratifikuar nga Parlamenti i Kosovës. Gjithashtu përcaktoi se akti juridik i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Statuti që implementon Parimet, duhet të plotësojnë standardet kushtetuese dhe duhet të jenë në pajtueshmëri me nenet përkatëse të Kushtetutës.<sup>7</sup>

Sipas qeverisë së Kosovës, ky Asociacion nuk do të ketë ndonjë pushtet ekzekutiv dhe nuk do të jetë një nivel i tretë i qeverisjes dhe Statuti i tij do të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe legjisllacionin e Kosovës si dhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të datës 23 dhjetor 2015. Sa i përket zbatimit të kësaj marrëveshjeje, Bashkësia/Asociacioni i Komunave me shumicë serbe në Kosovë ende nuk është formuar.

## 4.2 Debati rreth marrëveshjes

Çështja e kompetencave të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe ishte dhe vazhdon të mbetet një nga dilemat më të mëdha të dialogut Kosovë – Serbi. Kundërshtimi i ashpër i kësaj marrëveshjeje nga ana e partive opozitare në vend ka nisur fillimisht duke vënë në pikëpy-

<sup>7</sup> Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, AKTGJYKIM në Rastin nr. K0130/15, Parashtrues Presidentja e Republikës së Kosovës. I publikuar me datën 23 dhjetor 2015. I qasshëm në, [http://ëëë.gjk-ks.org/repository/docs/gjk\\_ko\\_130\\_15\\_shq.pdf](http://ëëë.gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ko_130_15_shq.pdf)



etje kompetencat e këtij Asociacioni, të cilat kanë nxitur një sërë reagimesh, bllokimin e punës së Kuvendit, gazin lotës sjellës dhe protesta në mbarë vendin.

Polarizimi i skenës politike si dhe kundërshtimi i partive opozitare ndaj këtij Asociacioni u bë arsye e ballafaqimeve të shumta në mes palëve në Kuvend ku përveç gjuhës së ashpër u përdorën edhe mjete jo demokratike si gazi lotsjellës, nxjerrjen jashtë të deputetëve opozitar me dhunë nga ana e Policisë së Kosovës.

Kundërshtimi i ashpër i themelimit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe u shfaq edhe jashtë Kuvendit, me protesta masive të organizuara jo vetëm në Prishtinë por edhe në qytete tjera të Kosovës.

Opozita vazhdon ta kundërshtoj këtë marrëveshje, por tani diskursi politik si dhe mjetet për kundërshtimin e kësaj marrëveshjeje janë zbutur. Kryeministri Mustafa më 15 janar 2016, ka deklaruar që Qeveria do të filloj me implementimin e marrëveshjes për formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe.<sup>8</sup>

Partitë serbe në Kosovë kanë ngrirë funksionet e tyre në institucionet e shtetit edhe për shkak të mosformimit të Asociacionit, ndërsa më 28 dhjetor 2016, pas takimit që kanë pasur me Kryeministrin e Serbisë z. Aleksandër Vuçiq kanë deklaruar se nëse Kosova nuk e formon Asociacionin

deri më 15 shkurt 2017 do të formojnë atë në mënyrë unilaterale<sup>9</sup>

Ende nuk është e qartë se kur do të themelohet ky asociacion dhe cilët do të jenë hapat e palëve të përfshira në këtë process. Gjithashtu nuk është krejtësisht e qartë se çfarë kompetencash do të ketë asociacioni dhe cili do të jetë impakti i tij.


## 4.3 PËRCEPTIMI QYTETAR

### 4.3 Çfarë kompetencash mendoni se do të ketë Asociacioni i komunave me shumicë serbe?

KDI është drejtuar me këtë pyetje për të nxjerr në pah se si qytetarët e vendit e konsiderojnë Asociacionin e komunave me shumicë serbe. Rreth 36% e qytetarëve e deklarojnë se (ASK) do të ketë kompetenca ekzekutive, rreth 33% e tyre deklarohen se nuk janë në dijeni se çfarë kompetencash do të ketë ky asociacion. Ndërsa rreth 19% e qytetarëve deklarojnë se Asociacioni do të funksionoj sikurse Asociacioni i Komunave të Kosovës, ndërsa rreth 9% e

8 <https://www.facebook.com/IsaMustafakS/posts/1219396574793244>

9 Koha Net, "Gjuriq kërcënon: Asociacioni i Komunave... deri më 15 shkurt ose ...", 4 janar 2017. I qasshëm në: <http://koha.net/?id=273&=150277>




tyre mendojnë se AKS do të funksionoj si mekanizëm me kompetenca legjislative kurse vetëm 3.3% e të anketuarve e shohin AKS-në duke funksionuar sikur OJQ.

E përbashkëta e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës është mosinformimi i tyre se çfarë kompetencash do të ketë AKS. Rreth 32% e shqiptarëve, rreth 33% e serbëve dhe 52% e komuniteteve tjera joshumicë në Kosovë janë deklaruar se nuk e dinë çfarë kompetenca do të ketë asociacioni i komunave me shumicë

serbe. Megjithatë, shumica e komunitetit shqiptar, rreth 37% e tyre, konsideron që ky Asociacion do të ketë kompetenca ekzekutive, gjë që besohet edhe nga 28% e të anketuarve nga komuniteti serb dhe 20% nga komunitetet tjera joshumicë. Ndërsa sa i përket kompetencave të tij si të çdo OJQ-je tjetër në Kosovë, janë rreth 21% e komunitet serb që e deklarojnë atë, dhe vetëm 3% e komunitetit shqiptar dhe 7% e komuniteteve të tjera.

### Çfarë kompetencash do të ketë Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe?







# 5. E ARDHMJA E DIALOGUT KOSOVË-SERBI NGA KËNDVËSHTRIMI I QYTETARËVE

Në vitin 2016 përkundrejt kundërshtimeve të opozitës për vazhdimin e dialogut në këtë formë, kushtëzimin e tij apo dhe zbatimin e marrëveshjeve të arritura, është diskutuar gjithashtu edhe rreth fazën së tretë të dialogut, nevojës për riformatimin e tij si dhe diskutimin e temave të reja që mbeten ende të pazgjidhura në mes dy vendeve.

Kryeministri Isa Mustafa si dhe Ministria për Dialog Edita Tahiri kanë deklaruar se dialogu do të hyjë në një fazë të re, ku mund të ketë ndryshime edhe në ekipin negociator por edhe në temat të cilat do të diskutohen me Serbinë në Bruksel.

Poashtu, është përmendur edhe mundësia që në këtë fazë të re, dalogu të udhëhiqet nga Presidenti i vendit z. Hashim Thaçi, ndërsa ai në deklarimet e tij në media ka shprehur se, beson dhe insiston se duhet të ketë ndryshim të dinamikës dhe agjendës së këtij dialogu sepse duhet të implementohen marrëveshjet e arritura.<sup>10</sup> Kjo fazë e dialogut është thënë se pritet të rezultojë edhe me një traktat apo marrëveshje të paqes.

Në një intervistë të dhënë në fillim të vitit 2017, kryeministri i Kosovës z. Isa Mustafa, ka shprehur nevojën për ndryshim të formatit të dialogut dhe është shprehur në favor që në formatin e ardhshëm të dialogut të ketë përfaqësues të Zyrës së Presidentit, të Kuvendit të Kosovës, të opozitës dhe të shoqërisë civile.<sup>11</sup>

Edhe Ministria për Dialog znj. Edita Tahiri, në raportimin

e saj në Komisionin e Kuvendit për Punë të Jashtme, me 26 tetor 2016, pati deklaruar se do të ketë një fazë të tretë përmbyllëse të dialogut. Ajo kishte ndarë më këtë Komision edhe një dokument të Qeverisë në të cilën përfshiheshin temat e propozuara nga pala kosovare ndër to edhe tema e të pagjeturve, ku do të kërkohej Serbisë që të paraqes vendndodhjen e rreth 1600 personave të pagjetur. Kjo fazë poashtu do të rezultojë me një marrëveshje ligjërisht të obligueshme, ku do të trajtohen reparacionet e luftës, demarkacioni i kufirit mes dy shteteve, suksesioni përkatësisht ndarja e pasurisë, si dhe do të ndodh njohje mes dy shteteve.<sup>12</sup>

## 5.1 Nga kush mendoni se duhet të udhëhiqet në të ardhmen dialogu Kosovë-Serbi?


NNga të gjeturat e hulumtimit në terren del se rreth 53% e qytetarëve të vendit konsiderojnë që për Kosovën duhet të negocioj një koalicion gjithpërfshirës i partive politike. Rreth 25% e tyre konsiderojnë që dialogu duhet të vazhdojë të udhëhiqet nga Qeveria, rreth 8% mendojnë që Presidenti i Republikës së Kosovës duhet të negocioj me Serbinë kurse rreth 13% e të anketuarve nuk e dinë se kë do ta preferonin për ta udhëhequr dialogun me Serbinë.

10. Shih deklaratën e presidentit Hashim Thaçi, në RTK "Thaçi: Vendi ynë ka vetëm rrugën Evropiane", 21 qershor 2016. I qasshëm në, <http://www.rtklive.com/sq/nees-single.php?ID=81856>

11. Shih intervistën e plotë të kryeministrit Isa Mustafa në, <http://www.ekonomiaonline.com/politike/mustafa-paralajmeron-ndryshim-te-dialogut-qeveria-sdo-ta-rrenoj-murin-ne-veri/>

12. Shih fjalimin e plotë të Ministres për Dialog znj. Edita Tahiri, në mbledhjen e Komisionit për Punë të Jashtme, 26 tetor 2016, në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,6250> (qasur më 16 janar 2017).






Sa i përket preferencave sipas komuniteteve, më shumë se gjysma e shqiptarëve të anketuar, rreth 54% e tyre, preferojnë një koalicion gjithëpërfshirës i cili do të negocionte me Serbinë, ndjekur nga Qeveria rreth 25% dhe nga Presidenca rreth 8% e tyre. Ndërsa rreth 12% e të anketuarëve nga komuniteti shqiptar nuk e dinë se kë do të preferonin për ta udhëhequr dialogun me Serbinë.


Në anën tjetër, shumica e komunitetit serb, 52% e tyre, nuk e dinë se kush do duhej të negocionte në emër të Kosovës

në Bruksel. Megjithatë, për serbët që kishin preferenca se kush duhet të udhëheqë dialogun me Serbinë, shumica prej tyre rreth 23% preferojnë një koalicion gjithëpërfshirës të partive politike, ndjekur nga Presidenca me 17.3% dhe Qeveria me 7%.

Koalicioni gjithëpërfshirës i partive politike preferohet për t'a udhëhequr dialogun edhe nga komunitetet tjera joshumicë në Kosovë (39%), ndjekur nga Qeveria (20%) dhe Presidenca (17%).

### Kush duhet të udhëheqë në të ardhmen dialogun Kosovë - Serbi







### 5.2. Cilat tema tjera mendoni se duhet të diskutohen në kuadër të dialogut Kosovë – Serbi?

Përkundër 19 marrëveshjeve të arritura deri më tani me Serbinë, shumë tema të rëndësishme ende nuk janë hapur për dialog. Duke pasur parasysh mundësinë e ndryshimit të dialogut dhe fillimit të një faze të re të këtij procesi, ekzistojnë mundësi reale të hapjes së temave të reja për t’u diskutuar mes Kosovës dhe Serbisë. Por, cilat tema do të preferonin qytetarët e Republikës së Kosovës që duhet të diskutohen në kuadër të dialogut Kosovë – Serbi në të ardhmen?

Sipas të gjeturave nga hulumtimi në terren, 84% të qytetarëve të Republikës së Kosovës mendojnë se duhet të diskutohet për çështjen e të pagjeturve, 75% për krimet e luftës, 65% për dëmshpërblimet për dëmet e luftës, 39% për njohjen e Kosovës nga Serbia, 33% për fondin pensional dhe 27% për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare.

Sa i përket ndarjes në përkatësi etnike, për shqiptarët temat kryesore të cilat do të duheshin të trajtoheshin në procesin e dialogut janë të pagjeturit (85%), krimet e luftës (76%), dëmshpërblimet e luftës (66%), njohja e Kosovës nga Serbia (40%) etj. Rradhitje e njëjtë e prioritetëve për temat që duhet të diskutohen në Bruksel kanë dhënë edhe respondentët nga komuniteti serb, duke shtuar edhe temën për fondin pensional. E njëjta vlenë edhe për komunitetet tjera joshumicë në Kosovë, vetëm se këto komunitete si të fundit në rradhë e kanë paraparë çështjen e njohjes së pavarësisë së Kosovës nga ana e shtetit serb.







# 6. PËRFUNDIM

Rezultatet e hulumtimit të këtij opinioni publik shpërfaqin këto të gjetura:

- 1.** Gjysma e qytetarëve të Kosovës janë të painformuar rreth marrëveshjes për kodin telefonik të Kosovës. Për më tepër, një përqindje e konsiderueshme e qytetarëve nuk dijnë cili shtet, Kosova apo Serbia, përfiton nga kjo marrëveshje. Vetëm 27% e tyre mendojnë se Republika e Kosovës është pala që përfiton nga kjo marrëveshje.
- 2.** Qytetarët e Kosovës nuk kanë një qëndrim uniform rreth kompetencave që do të ketë Asociacioni i komunave me shumicë serbe (ASK), një pjesë e konsideruar e tyre (32%) janë shprehur se nuk janë kanë dijeni rreth kompetencave të këtij mekanizmi. Ndërsa pjesa më e madhe e tyre mendojnë që ASK do të jetë mekanizëm me kompetenca ekzekutive.
- 3.** Shumica dërrmuese e qytetarëve të Republikës së Kosovës vlerësojnë se dialogu Kosovë-Serbi në të ardhmen duhet të udhëhiqet nga koalicioni gjithëpërfshirës i partive politike. Rreth 25% e tyre vlerësojnë se Qeveria duhet të udhëheq këtë proces edhe në të ardhmen, ndërsa vetëm 8% e tyre mendojnë se ky proces duhet të udhëhiqet nga Presidenca.
- 4.** Të pagjeturit, krimet dhe dëmshpërblimet e luftës, fondi pensional, anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe në përgjithësi njohja e Kosovës nga Serbia janë temat prioritare dhe më me interes për qytetarët e vendit për t'u adresuar në kuadër të dialogut.

## 6.1 Rekomandime:

- 1.** Qeveria e Kosovës duhet të angazohet në mënyrë aktive që ta bëjë sa më transparent procesin e dialogut Kosovë-Serbi, t'i njoftoj qytetarët drejtë dhe në kohë rreth përmbajtjes dhe efektëve të marrëveshjeve të arritura si dhe t'i publikoj të gjitha marrëveshjet.
- 2.** Institucionet e Republikës së Kosovës, më konkretisht Qeveria dhe Kuvendi, duhet të angazohen në forume dhe diskutime publike me të gjithë qytetarët e vendit për ta bërë transparent dhe gjithëpërfshirës procesin e themelimit të Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe, duke shtjelluar në detaje kompetencat të cilat pritet t'i ketë ky mekanizëm.
- 3.** Format i pjesëmarrjes së Kosovës në dialogun Kosovë-Serbi duhet të jetë temë e diskutimeve konstruktive midis të gjitha subjekteve politike në vend dhe të përfundojë me konsensus të gjerë politik mbi strategjinë dhe ekipin që do të mund t'a përfaqësojë Kosovës në dialog dhe përmbajtjen e temave që të do të trajtoheshon në kuadër të këtij dialogu.
- 4.** Përfaqësuesit e Republikës së Kosovës në dialogun Kosovë-Serbi duhet të marrin në konsideratë kërkesat e qytetarëve rreth temave të cilat duhet të diskutohen në këtë proces, për të garantuar një proces llogaridhënës që i përgjigjet nevojave të qytetarëve të vendit në përputhje të plotë me parimet dhe vlerat demokratike.

Për më shumë informacione rreth dialogut Kosovë-Serbi klikoni te [www.votaime.org/Public/Dialog](http://www.votaime.org/Public/Dialog)







